# DËSHMI ARKIVI

**A-449128**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | VIDEO - Ftesa/ Berisha: Vizita ime në SHBA duhet të shërbejë si një apel bashkimi për të gjithë demokratët |
| ADRESA | `https://www.syri.net/politike/917082/ftesa-berisha-vizita-ime-ne-shba-duhet-te-sherbeje-si-nje-apel-bashkimi-per-te-gjithe-demokratet/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 12:27:19 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 12:17:51 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 6e12ec108063c95a0f65adbeb447137e54c26c943dc5ef05a62da42228eaa548 |
| TEKSTI | d07100b952d8794ae48311242b0e54b1f00a9e85c2dd51d4e8352c665769d7e0 |
| PAMJA | d10cb1c5c89e254f8adb9ccbc1e8b5cda0f7c61ca81e637483ca4d3dd0769ed6 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 93a073489d3ea5d3ab48b7bfc385c3e0e3b9f530b234071d619460007aed78e6 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/93a073489d3ea5d3ab48b7bfc385c3e0e3b9f530b234071d619460007aed78e6`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



**NDRIÇIM KULLA**
Gjuha si brushë dhe ironia si armë e Edi Ramës



**IRENA BEQIRAJ**
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

LAJMI I FUNDIT
Reagimi/ Kurti: Udhëheqësit e UÇK-së nuk u dënuan me vullnetin e popullit

# Ftesa/ Berisha: Vizita ime në SHBA duhet të shërbejë si një apel bashkimi për të gjithë demokratët

14:17, 16/09/2026

ZMADHO TEKSTIN
+ Aa -

Gjatë mbledhjes me grupin parlamentar të PD-së, lideri demokrat Sali Berisha u ndal dhe tek vizita (4 - 12 shtator) e tij në SHBA së bashku me kreun e PR-së Fatmir Mediu dhe një delegacion. Ai nënvizoi se vizita e tij në SHBA duhet të shërbejë si një apel bashkimi për të gjithë demokratët që e kanë konsideruar ndalimin e vizës si një pengesë për bashkimin me ne.

**Pjesë nga fjala e sotme e Sali Berishes**

Zonja dhe zotërinj, siç jeni informuar, javën e kaluar ne, me një grup drejtuesish të PD, morëm pjesë në konventën e Partisë Republikane të zgjedhjeve afatmesme, i ftuar nga IDU për të marrë pjesë në këtë konferencë së bashku me zotin Fatmir Mediu, kryetar i Partisë Republikane, anëtar i IDU si parti, njëlloj si ne.

Vetëkuptohet, pavarësisht nga komentet, kjo nuk ishte një vizitë personale, nuk ishte një udhëtim personal, nuk kishte asgjë personale në këtë udhëtim.

Ishte në respektim të një ftese dhe pjesëmarrje në aktivitetin më kryesor të partisë në pushtet, Partisë Republikane.
Para se të shkojmë aty, ne patëm një takim të shkëlqyer me diasporën dhe shpreh një mirënjohje të pakufishme ndaj tyre për pritjen që na organizuan, pritjen vëllazërore, angazhimin, mbështetjen e jashtëzakonshme.

Në konventë, faktikisht Dallasi ishte kthyer në kryeqytetin politik, të themi, të SHBA ato ditë.

Ndaj dhe ne patëm rast të bëjmë takime me personalitete të shquara, si të Kongresit të SHBA, por edhe të administratës së presidentit Trump.

Në të gjitha këto takime, ne kemi paraqitur realitetin shqiptar sipas mendimit tonë. Dhe, jemi ndalur në dy çështje më themelore, narkoshtetin dhe farsën zgjedhore.

## më të lexuarat

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia

PD: Shpopullimi i Shqipërisë, një krizë që po zbraz vendin dhe po rrezikon të ardhmen e tij

Mendoj se kemi gjetur mirëkuptim real me bashkëbiseduesit tanë.

Siç është faktuar dhe në qëndrimin e Sekretarit Rubio ndaj zgjedhjeve në Shqipëri, që nuk dërgoi mesazh urimi, sepse sipas zëdhënësit të DASH, ai uron vetëm zgjedhjet e lira, pra e qartë që administrata njihte zhvillimet në procesin zgjedhor, dorën e zezë, siç e shprehu dje kryetari i komisionit të Helsinkit në Kongresin e SHBA, Joe Wilson që tha se janë përdorur nga Edi Rama, organizatat kriminale, faktorë të tjerë për të ndërhyrë në zgjedhjet.

Dhe, mendoj se këto takime ishin shumë të dobishme dhe shënojnë konsolidimin e një dialogu intensiv të PD me SHBA, bashkëpunimin me këtë vend të madh.

Por nga ana tjetër duhet të them këtu se ky udhëtim i imi duhet, dhe shpresoj të shërbejë, edhe si një apel bashkimi për të gjithë ata demokratë dhe demokrate, që gjer sot kanë konsideruar ndalimin e vizës për Sali Berishën si një pengesë për t'u bashkuar me ne.
Unë i ftoj ata të kthehen te kontributet e tyre.

Ata janë njerëz që kanë kontribuar.
Nuk e kam fjalën për aksionerët, bashkëaksionerët me qeverinë, se ata nuk vijnë edhe po t'u them unë edhe 100 herë, ata nuk i lënë aksionet e tyre.

Por e kam fjalën për shumë të tjerë, të cilët për mendimin e tyre janë distancuar nga partia, nga udhëheqja e saj, etj me radhë.
Është një moment që t'i ftoj me shumë sinqeritet, me shumë përzemërsi, dhe u ftoj ju të gjithëve që këtë qëndrim të mbajmë në mënyrë që këta zonja, zotërinj, që janë opozitarë, që qëndrojnë opozitarë, të rikthehen tek investimi i tyre, tek partia e tyre.

© SYRI.net

Lexo edhe:


Reagimi/ Kurti: Udhëheqësit e UÇK-së nuk u dënuan me vullnetin e popullit


Vendimi i Hagës/ Osmani: UÇK, pjesa më krenare e historisë moderne të popullit tonë: dje, sot e përjetësisht!


Dënimi i ish krerëve të UÇK-së/ Berisha: PD beson se apeli do bëjë drejtësi! Gjykata justifikoi akuzat bajate të padronit të Edi Ramës

Urimi dhe mesazhi i Metës: PISA janë një tjetër dëshmi e gjendjes alarmante të shkollave! Për PL-në arsimi prioritet

'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

Ngërçi me pagat/ Gjykata e Kukësit mbyll dyert për qytetarët 3 ditë

## TË NGJASHME

Vendimi i Hagës/ Thirrje për protesta më të fuqishme, griset flamuri i BE

Berisha: Vendimi për ish-drejtuesit e UÇK-së i padrejtë! Asgjë s' mund të errësojë luftën çlirimtare të popullit të Kosovës

'Dënime absurde, qartazi politike', Meta: Lufta e UÇK meriton piedestalin e krenarisë patriotike

Tensione pranë ish-ndërtesës së EULEX-it në Prishtinë, qytetarët mësyjnë selinë e rrethuar nga Policia

Dënimi i ish krerëve të UÇK-së/ BE-ja bën thirrje për përmbajtje: Gjykata ta kryejë punën pa ndërhyrje

Elshani: Situatë e qetë në veri, Policia e gatshme të reagojë në rast incidentesh

Audiopërgjimi i Ahmetajt/ Reagon shoqëria DEL-CNG SHPK



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.